



UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA
DIPARTIMENTO DI LINGUE E SCIENZE DELL'EDUCAZIONE
LABORATORIO DI ALBANOLOGIA
UNIVERSITETI I KALABRISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVET DHE I SHKENCAVET TË EDUKIMIT
LABORATORI I ALBANOLOGJISË



Opere di Francesco Antonio Santori

a cura di

Vincenzo Belmonte

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

MELLODHRAM' ALBËRESH

[LEVKOTEA]

Vetëte

Levkotea e

Jullja - *motëra të*

Kostondinit - *e të tri bil të*

Dilsë - *shoqe të Dinit, çë vëdiq.*

Aristidhi - *trimë çë do e është i dashurë ka Levkotea*

Vallja gjitonshi e gjërishi

Shena

është ndë katund e ndë vende prë nënë katundit. Hapetë ndë një llak anamesa di rëhjeve, ka mbi njerin e të cilëvet shihet katundi; mbi të jetërin, ndë llak e ndër të duken këtu këtje kopshte, vreshta, tupe, ferra, gramī e të tjera fitepse. Kundrela llaks proposh një lumë. Dielli rrī prej të perndonjë. Levkotea je vetëme vete sikurë tue kërkuerë diu çë shërbes tek thelli ji llaks. Qëndronë prana ndë një vend më ji vetullorë. Fjet një çik ndën zae, sikurë me vetëhënë; lartën dal e dal të folëtë, e mbë serpos vëhet e këndonë.

PJES E I

Shenë je I

Levkotea je vetëme anamesa llaks. Aristidhi që vete ka poshti prej çuks të rahjit, ku pra qëndrônë i fëshehurë.

Levkotea

Çë kâ prë mua të miri,
të bukuri çë kâ
kî vend i vetëm' e pa njeri prë nënë?
Kë vete tuke gjënë
ng' e shoh pindiksurë ndë kto fjeta ulliri. 5
Të dal së njoh një vâ
ka qënura të shpirtit i helmuorë.
E kî vend më pëlqënë,
pa diturë po si vete e po si vjenë.
M' u ndot se diu çë pë, 10
një fjandaksëme, një hjë.
S' u trëmba e gjurmat vajta tue kërkuorë.
I ndodha e nëng i njoha.
Po kurmin gjith një herje m' e zû vapa.
U ngroha e u ftoha 15
trî herë, e pa të dinja çë m' psoi.
Fëshehtë një fuqî
eshtrat më ngau, dellit më shkundi e shkoi.
Piejta këtu e këtje
ajrin e vendet të m' e thojn dreq 20
këtena kush udhisi e kush qe.
Fitepset çë më rrinë përpara e prapa,
lulet e gjëmbat çë më janë ndë tal,
së tunden e së pipnjin ndonjë fjal.
E qetëme nënë më shtrohet mua gjithia, 25
si kurë më ruonë çë thomë, çë dua të bënë.
E u vet nëng arrënjë
po të mun të ndilëgônjë
çë lutinjë e kërkonjë,
ndo mirë o lig më vjenë. 30
Si vete poka çë më se mjal
ëmbël më nditet gjella
ndë këto llaka qetullore e thella?

Kush m' e muori, kush m' e shquori,
kush m' e vodhi zëmërën? 35
Çë kurë xuri ç' është namuri,
më s' e kamë të nëmurën!

Qe vërteta o qe je rreme?
Qe një bëme o një gënjeme?
Prë vetëhenë u nëng e dī
ndo qe ëndër o fjandaksi. 40

Shenë je dit

Jullja e Levkotea

Popo, popo! Motëra ime,
ti çë bënë e vetëme ashtu
te kjo vresht, ndë kët llakat
merëngore, çë ndë zëmërë 45
të këllet një trëmbësime
keq thellishte, çë shtrëmbōnë?
Ti je vetëm' ashtu mënōnë
e s' kultōnë ato çë kanë
kūrë prë tij e valandī? 50
Mëma, pjote anangasī,
tas çë priti prë ca herë
ndo se vinje e nëng të pā,
zuri nje të trëmbej keq.
Të kërkoi para ndë shpī, 55
pra ndër miq e ndë gjëri,
ndë gjitōnë e vendëve gjith
të katundit, ku të venje
kishnje, o motërë, prë zakōnë.
Nëng të gjeti e mëngu mbrënda 60
Kosta ish, po t' e dërgoj
të t' kërkuj, ku mūn të gjëj.
Kurë e pē helmuore keq,
nisa drej u të të çonja,
moj ku venja nëng e dinja 65
të t' kërkonja e të t' thërrinja.
Si pa dashurë jasht u gjënda
ka katundi e suolli mua
vetëme këmba ndë kto brinja,
njera te kī thellë përrua. 70

Levkotea

Kush jē ti çë vjēnē kētu
ëndërrat [t]ime të tërbōç?
Thelli mallë çë ndruollë më strosën
nëng më sosën të më grisinjë?
Njo, vidhjore gjindja edhe 75
mëngu e vetëme do t' më lërrë

prë një kred, i shkurturë keq,
po të qanjë o të këndonjë
fanin timë, si mua më ndjet.

Jullja

Qiell, çë shoh! Çë vjenë me thënë 80
një ndërruom' e thelle ashtu?
Motëra ime, ti më fjet
si nj' e lënë ka ligja e dreq.
Popo! Keq kī vend i vet
mendën e bukurë të thjellmore, 85
çë t' pastroj e të nderoj,
shum t' e vrëjti e t' e shtrëmboi!
Vemi, motërë, vemi! Mëma
do të gjëndemi ndë shpī
nënë asaj, më parë se mbrëma. 90

Levkotea

O Jullje, poka ti afërë më jē?
O drit, o hję, çë pathër më gëzove
ndë helëme, e më dritsove kurë m' u lips.
Ndo pata një harë, m' e bëre di,
po si m' e bënë nani. 95
Qasëmu, qasëmu, ndë kto llorë m' u shtro,
motërë vërteta e mirë,
urtëri je pjonë e hirë, çë meritōnë
po të t' shtrëngonjë ndë timin krahua
me gjith fuqinë e mallit, me k' të dua. 100

Jullja

Vemi, këtena, o motërë,
vemi më sipërë mbal një terimoni.
Atje dielli na sheh e na shkëllqënë
ji bukurith ndë sī
e na mbjōnë me harë. 105
Katundi edhe kundrela çë na rrī
bën' e përhapet zëmëra, e na pëllqënë
të folëtë më, pse pa trandaksī.
Mënonjëmi atje një kred. Ndo ënda kē,
më thua çë pē, çë pate, çë pësove; 110
ndo Dreqezën prostekse
o prë ndonjë shtrush u rekse,
o ndonj' etërë trëmbime
shpirtin të tramaksi, o motëra ime.

Levkotea

Vemi, se u edhe, 115
trëmbem të rrī këtu.
Ti ruoj, motërë, këtë
mbero ku qeva u
ndo se sheh gjë.

Më solle dritën ti, 120
më hape mendën edhe.
Më nxierë këtëj nani?
Moj u të thomë se atje
shpirtin e lë!

Jullja

Priru mbë vetëhënë, 125
o mōtërë, e tund me rē
kurmin, këmbat e stanë.
Njota se neve ndanë
një fos përpara vjenë
mbuluorë me hith e ferra. 130
Na biemi e gjith të shqerra
qëndronjëmi, ndo se ti me fjandaksī
të dhezurë ecën e si je llavurë rrī.

Levkotea

Ke ligj, ke ligj, o motërë.
Mos priremi mbë trū, 135
jamë si nj' urdhī pa hū.
Njota, një ferr i thārt këmbën më shpoi,
një hīth më përvëloi
dorën të djathte, e më tramaksi gjinë
e verdhe e keq je madhe një xhapī, 140
cila me ohjistre sī
më ruojti e prana u stros.
Shë' Mëri! Një bretëkos
mbi këmbën më shtëlloi
e kurmin më skotisi e m' e shtrëmboi. 145
Popo! Së mund kufinjë,
o Julle, e ajrin me fuqī dëthīnjë!

Jullja

Vemi, po ndovorria
na prikulin e shkuomë!

Fosin të gjerë e thellë
bukurë e kapëtuomë
si flutura të dia. 150

*Të rrëvuora mbi kocorahjin, pushonjin. Levkotea ruonë prë
nënë, i pëllqënë vendi e thot.*

Levkotea

Kërciemë si kacamite ndë ktë rahj,
rrëvuomë njëhere keq,
si ajo vete dreq 155
kurë gjëndet e përzënë,
ku hjë po të pushonjë o uje gjënë.
Më llaftarisën zëmëra, moj harë
gjegjinjë të madhe, se gjëndem këtu.
Vërteta ndë ktë rahj qeshën gjithia. 160
Më hapetë zëmëra e më pëllqënë më gjella
se nd' ato llaka thella...

Jullja

... ku ti lëngonje thomëse edhe nani,
mos keshënj' ardhurë të të zgjonja u
ka gjumi kequllorë çë të qëlloj 165
e thomëse të poshtoj te jetëra gjellë.
Njota katundi si na rrë kundrela!
E ka kjo anë ndo ruonë,
prosteksën vreshtën tënë.
Ndo sītë pëstajna ngrënë, 170
vrenë diellin çë perndonë.

Levkotea

E malle sa më zgjonë së mund i thomë,
se shpirti ndo i kultonë, kurmin m' e thanë.
Priru te kjo anë, o Julle, dreq
nani e këndo me mua 175
një kënekëz ëmbëlore
mbjatu, si u e dua;
këndonjëmi ani, këndonjëmi na të dia,
mbë vok të hajdhjare,
një vjersh, sa të m' duliret fjandaksia. 180

Jullja

Kulëto të jët' i shkurturë vjersh, o motërë,
se mëma çë rrë neve tuke priturë,

prë sa mënonjëmi, më gjegjën të ngjaturë
dhurimen çë prë në ndë zëe mbullinë.

*Këndonjin vjershin të dia tue u mbajturë duorshit, e të prjerra
dreq ka lumi aposhtaz. Aristidhi tek jetëri rahj, ulurë mbal një
brinjë, ruonë e gjegjën, pa të jetë i parë ka Jullja, i pandehjurë mbero
ka Levkotea.*

Vjershëthi

Më shkove para sive po si shkonë 185
rrëmbi ji bukurë, çë ndë verë shkëllqënë
ka nj' illë çë duk se ikën e fjuturonë,
e vendin te ku qe ti më s' e ndjenë.

Këndimez

Vendi vërtet harrohetë 190
ndë qiellë i gjat e i gjerë,
moj nëng harronet bëmjja
çë të pësoi një herë,
kudo kã qënë, kudo.

Brinja, përroi e llakëza 195
e rahji e mali e sheshi,
vendet sa janë ç' e gjasën
bën' e të rekset veshi
e siu e zëa me to.

Kundërekëndime

*me k' Aristidhi bënë ekun atire tue përgjegjurë ka llarghu me zae
të mblliturë e të ngjaturë.*

T' e thonë e t' e kulëtonjin 200
e t' e rrëfienjin gjith
shërbisetë, çë të rrethënjin
përparaz e ndë vith.

Jullja

je skotisurë e je cjudhiturë i thot së motërës:

O Levkotë, më ndot se tek ai rahj 205
çë neve rrī kundrela,
tek ajo brinjë tutje,
ndënë kumbullën të kuqe
çë kã te vreshta Bela,
përgjegji një këndimez ëmbëlore.
Mos neve qellën dhunë ndrikulla Tore?

Levkotea

Vërteta? Nëng e gjegja! Qetu, qetu! 210
Njota se n'etërë herë këndimen zuri
me zae të lartullore e shumë të doqe.
Ësht ajo? Nëng është ajo? Më ndjet
se dreq asaj i gjet.
E njoh e nëng e njoh... O Julle, 215
mirr vesh e vëri rë,
e, se t' e gjegjëmi mirë,
ulemi te kjo hjë.

Këndimeza je llargh

Një herë, një herë çë zëmërën 220
të mudi i thellë një mallë,
vendi ku qe të mbahetë
ndër sī si bardh spiqallë,
si një pasqirë çë fjet.

Të thot çë qe, çë ndiejte, 225
te zëmër' ani çë kē;
si t' u fjandaks i bukurë
shërbesi çë ti pē,
shërbesi çë të gjet.

Ahiena tundetë zëmëra, 230
shpirti të fjaturonë,
e kurmi si vëdekurë
ndë vend ku jë qëndrōnë.

E zëa përpyek si nd' ëndërr 235
mirin çë luti ajo,
e nget, e llorën, e puthënë,
je ruonë e i fjet si do.

Jullja

Majde si dī e këndōnë! Kush është atje?
Kā zanjën armonisore e të dëlire
më shumë se nëng e kā ndrikulla Tore.

Më njomi zemërën 240
e, ndo këndoj
nj' etërë thërrimez,
shpirti harroj
miq e gjëri.

Është keq e ëmbël 245
e voka e fjala.
Thellet ndë shpirtin,
si nd' uje ngjala,
ajo jonë.

Levkotea

Mbajëm, o Julle... U bie prë trolli... u fare 250
së mun të rrë shtuora; më dridhet kurmi...
më vrëhet drita e më mbullihen sītë,
më mirren trūtë, e duket mbjatu mua
se ndë një hjime rrukullisem posht.
U s' dī çë kamë ... ku jamë... u bie zalī!... 255
Julle, çë bënë? ku rrë?...
O! Ndëj lipsjaren dorë!
Motërë, shtrëngomë e ngrëjëm nd' ato llorë!

Jullja

Ajlimono! O mjera u e zeza!
Motërë, çë ndienë? çë kē? 260
Kumbisu mua ndë prëhërë te kjo hjë!
M' u veshke, si një lule
veshket përpara zjarrit gjith një herë.
Si kungullith skarmaturë u verdhove,
e zeslesh mua ndë duorë kuazi qëndrove 265
vëdekurez. E ni si bënë u mjera,
tas çë më zuri hera,
të të qellinjë ndë shpī
këtej pa mosnjerī?
O qinë çë më përzë! O zjarr! Çë shoh? 270
Një trimë i armatosërë vjenë këtena
përdreq e u s' e njoh.
Ku ikinjë u e zeza,
ku shehem pa të tjera
motrëma ndë ktë lipse ashtu të madhe? 275
O Jëmë qiellsore, ndëjëm ti fuqī
o trūtë të mos na dëminjë ndrit këtij,
çë vetëme ashtu na gjënë,
pa skis e pa këshillë;
o bëj të jetë një mik o ndonjë gjërī. 280

Shenë je tret

Aristidhi e të thënatë

Nëng ju njoh e nëng ju jamë
jo gjitënë e jo gjëri,
moj prë jū të madhe kamë
një trilarde valandī.
Thuom', o vash, çë mun të bënjë
u me dorën çë të ndënjë.

285

Jullja

Ndihëm, trimë, po mos më ngit.
Ndihëm sa ngalosha vë
motrën time, e jo më gjë
dua ka ti prë mot e vit.

290

Ndera jonë të qoft' e truorë.
Vetëm' e qellinjë u ndë shpī,
pa të kemë prë nënë njerī
o t' e ngasën huoja duorë.

Aristidhi

Kopile zëmëremadhe,
xëje ka gola ime, mos ng' e dī,
je rënde një vërtet:
se shpirtit nëng përgjegjet nje fuqia
të kurmit, si të thotë se ni mund bëçë
me motrën tënde. Nëng e mundën vet.
Duhet poka t' e qellinjë nj'etërë krah.
Duhet e burrishte një fuqī
t' e ngrënjë mbi llorë e qellinjë ndë shtëpī.

295

300

Cado herë vëlema jonë
shumë shërbise do t' shtrëngonjë;
kurë pra dora t' i mangonjë,
pa të bënura qëndrënë.

305

Pather jo, pather duania
nëng qëndronë e mbrazëte gjith,
ndo me të shërbenë fuqia,
ç' është e mblirë ndë doqe vith.

310

Jullja

Jo, mik, jo! Motrën time mos një dorë,
çë kopilje nëng ë,
t' e ngas u mund e lë.
Kurraj dua përmëtonjë këtë shërbes,
pëse ndë turpëri,
ndë fjal e judhikī,
çë gjindja pather bënë,
kudo një ligjez gjën, s' dua të kemë pjes.

315

Aristidhi

Një lule e birë te shura
shkulij një trimë një herë
për t' e qandoj ndë kopshtith
ku mirë mun rroj e gjerë,
të thahej pa trëmbimë.

320

Së deshi e thirri lulja:
"Lejëm të rrī, o ti,
ku bīta e tërë e virgjërë,
si mbeta njer' nani,
je vet, me fanin timë!".

325

Trimi lulen e lëshoi,
si ji trëmburë e i mërīrë,
përse lig mbjodhi prë mirë.
Moj atena ndodhi e shkoi
i përzënurith një derr:
lulen shkeli e la të shqerr.

330

335

Jullja

Popo! Ndreti? E me të drita
më perndoi. Një burr, një burr,
si të jetë, o trimë o pjak,
shumë vëlënë më se një grua.
Njerë çë ndënji ai me mua
më shpëllqej, moj nëng më trëmbij,
nëng më ndit se vinej nata.
Popo! Andaj të moçëmit [t]ānë
me vërtet të thelle thanë
se kurraj së njihet miri
mos i zbjerr e i trashiguorë.
Nani, vetëme je qëndruorë,
sellpizore e je helëmore,
kuji truhem' o thërres?

340

345

Me k' e marr? Vetëm fëtesa: 350
ndihëm së desha e s' mun të ndihem vet.
O motëra ime, popo!, ti thërret!

Levkotea
si kurë ëndërrën

Ka ikën? Ku vete? si zëmra t' e bënë?
Mua mjeren, të shkrete, zaliturë të lënë,
ti fjeturënë si zog? 355

O mirrëm o lejëm! Lërëmë, po të varrisurë!
O bashk me tij qellëm ndë vend ku jë i nisurë
të të shërbenjë si rrog.

Çë do ka u je mjera?
Çë pret më, o mixorë? 360
Të rë mbë llorë si hera
fanmire bie ndë dorë.

Jullja - shumë e babaturë

Levkotë, ti zbandjonë?
Çë dit je sfanisore qe prë në
kjo je sodëme! Illi thomëse u vrë 365
çë na shkëllqej, e nëng na ndritën më.

Levkotea - tuke ëndërrërë

Mirrëm me tij, o ëngjëllë,
mirrëm e mos më le!
Mos ndikuro se thirrënjin
vëllau e mëma edhe. 370

Me nj' ëngjëll s' mun të zbiremi,
me nj' ëngjëll s' mund lëngonjë.
U bashk me tij Parrajsin
e shoh e trashigonjë.

Jullja

Vërteta i dërguorë dukej ka qielli! 375
I bukurith e i mirë,
pjonu prudhenxje, mallë, butsi e hīrë
ish trimi ç' u fanes
po të më ndihij ndë ktë lipse madhe.
U nëng e desha e s' dī të thomë pëse. 380
Je metanosurë, e lutonjë nani
çë llarghu vate e nëng më gjegjën ai.

Levkotea
je ardhërë mbë vetëhënë

Motërë, të gjegjinj' u,
mos nëng të gjegjën ai. 385
Me mua pa u trëmbërë rri
si gjënde ani këtu.
U prora mbë vetëhënë, po s' kamë fuqī
se t' ecinjë dreq mbi këmb njera ndë shpī.
Mënonjëmi nj'etërë kred 390
se prana dal e dal nisem' e vemi
si më të mundëmi hollë,
tas që katundit llarghu shumë së jemi.

Jullja

Popo! Më therën zëmërën
një fjaj që thua ti, motërë,
moj jëmën s' mund harronjë. 395

Sa keq mbi nē pandehjën
vëllau që ruonë e njeh
se mëma s' mund pushonjë!

U s' dī ku kamë të ndahemi
ndë malle që m' luftonjin: 400
cilit përgjegjem parë?

Për tij losemi, thahemi;
për ta që na kërkonjin
shpirtin e ndjenj të ndarë.

PJES E II

Shen' e parë

Dila e Kostondini

*Dila ka praku i derës të shtëpīs prosteksën të birin, cili
vate tue kërkuorë të motërat e, pse nëng i gjeti, priret i helëmuorë:
ajo thot je vetëme vjershezit të parë, e prana kur' i qasetë ndokën.*

Ninën dreq buftōnë ndë çerë 405
kush ka zëmërën të ngarë.

Drita e shehurë s' mun të rrjerë
je dërguorë ka ndonjë linārë,
ndo linari ng' është i mbllirë
ka një rë je sfanëmirë. 410

Njota, priret i helmuorë
biri jimë e keq buftōnë
ndë të vatërë, se s' kã çuorë
zgjerrat motëra çë kërkonë.
Popo, popo! E mjera u! 415
Çë të bënë sonde kështu?

Birë, ti prire i vetëmith
e ndë faqe helëmjn kē
të pindiksurë shumë të zī.

Ti, si buftōnë me qellurën të shkrete, 420
kërkove ndë gjith vende
motrat e nëng i gjete.

Kostondini

Vërteta, mëma ime,
vajta ndë vende gjith ku mun të venja. 425
Thërrita edhe këndova,

e udhëvet sa përpoqa
trima, kopile e pjaka,
burra e ghanjun i pjejta;
vajta prë brinja e llaka,
ndë sheshe, rehje e male i kërkova 430
e mosgjakunë i çova.

Dila

O birë! Popo, çë mbrëma
të keqe suolli sot dita prë nē!

O! thomëse i zuri nëma
çë pa duanī i kamë dërguorë ndonjë herë. 435
Ka ngasëmi, ku kërkonjëmi nd' errësirë?
Dimi ku vanë, dimi ku janë, o birë?
Moj çë qëndronjëmi ashtu
të babārturë këtu,
tuke priturë ato, 440
ndo vinjin ëh o jo?
Dhezëmi një torqe, si të jetë, e vemi
gjith sonde tue kërkuorë
e shën Maries e Qiellit tuke u truorë.

Shenë je 2

Vallja e të thënë të

Andaj si një llakat pa diell', e zez, 445
çë somenat na dukej gjithonia
e si një grua me gjerë zilōnë pa brez.
E rughat gjith i zotëroj shkretia,
pëse mangojin Jullja e Levkotea:
njera drita prë nē, jetra harea. 450

Qielli, jo, së kā të na jap
këtë helëm' ashtu të madh.
Kēm t' i shohëmi nd' at aradh,
tek i pamë njera nani.
Më hareme se ng' u hap 455
somenat dita je rē
ka të na mbllihet: prēm ndër nē
ato vashaz duomi ati.

Kostondini

Njota, o mëma ime, torqen dheza,
e nj'etërë di pa zënura ji mora; 460
E janë ashtu të thataz e të leza,
sa nëng i ndjenë po dora.
Shkuore nëng ësht prë sa na duket hera,
e, ndo s' bastōnë kjo,
na dhezëmi prana ato. 465

Dila

Vemi, bekuomi birë! Mbero përpara
tëfalëmi S[hën] Mërinë, të na bënë hirë
të ndodhëmi motrat [t]jēnde
pa mosnjë dēm, shëndoshëme e mbë të mirë.

Mbë di

Lipsjare Jëmë, prë helëmin 470
çë pate, kurë ti zbore
tëndin djal e vajte
tuke kërkuorë helmore,
sa, kurë e pate gjeturë,
u rekse prë harë; 475

lipsjare Jëmë, prë hajdhinë
çë ndejte ahiena ti,
bëj të përpjek nani
bilat e mia ku vanë.
Lemë të godinjë ku janë, 480
të vete dreq atje.

[*Vallja*]

Si vete dreq ania qellurë ka era
ç' i frinë aprapaz e je shtinë përpara
mbi dejt e te proiti arvönë karrera
ku gjënë bëgatëri shum' e pangara: 485
ashtu ti, jëmë, ku bilat [t]ënde janë
rrëvofç e i gjëç se mosnjë dëm të panë.

*Vallja ndë mot çë këndonë pjesën e saj, Kostondini e Dila
nisen e dalën katundit e tue shkuorë prë rrëz një kocorahji
gjegjënjin një këndimez, e i thot së jëmës ai kurë lë të
kënduorit vallja.*

Kostondini

E gjegjën, o mëmë, o jo këtë këndime?
Ësht e vërteta o thomëse nditet mua,
e bënurë veshëvet [t]ime? 490

Dila

Jo, birë, jo, birë, është e vërteta. Rë
vëmi të mbledhëmi ka na vjenë, çë thot.
Se thomëse ini Zot, po të nderonjë
fanibardhen Marie,
ndonj' udh na hapën, e ndonjë drit buftönë, 495
me k' mund kërkonjëmi dreq
vendin ku thomëse janë
tuke priturë ato ndihëmen çë s' kanë.

Shen' e 3

*Dila e Kostondini që venë udhës prej një kocorahji, ka mbal
cilin këndonë*

Aristidhi

Ti me faqen ërgjënde, shkëllqeme,
dil, o hënë, me bardhe tū brira. 500
Ti, të natjes o shoke hareme,
rrëmbat [t]ënde dishëruome zbulo.
Prë ndë llaka e ndë gropa të thella
bëj të mblidhet e ndëndët errsira,
e ndë vende ku njerzëvet ë gjella, 505
shtatebardhe, fanmire rrëmbo!

Dila

O Kost, kurraj ndë zëmërë e ëmbël' ashtu
më hiri ndonjë zae
si ani kjo këtu!
Kjo shpirtin m' e rrëmbeu 510
me një fuqī që s' qe njohurë ka dheu.

Aristidhi

*i mboshtuorë ka çuka e rahjit, ka prap një terimon afër' udhës
këndonë.*

Të kërkōnë, të lutōnë
thomëse vasha ç' u kā zbjerr
e të mblidhet udhën e s'njeh.

Të thërret, shumë të pret 515
thomëse jëma zëmërëshqerr,
se fëmilën prej ngë sheh.

Shen' e 4

*Dila, Kostondini e i thëni, që serposën kënduomen tue rrëvuorë
nd' udh.*

Dila

O, si godite, lumi ti, o kopil,
atë që kamë lutuorë e ani lutojnë.
U, njetani, kërkonjë 520
di bila tas të zbjerra e s' dī ku vete,

je zmarmaturë e shkrete,
 këtej e atena, si një zog pa krah.
 Tij, ëngjëll çë këndove
 e mbrëndin më zbulove tue kënduorë, 525
 tij, ëngjëll, qofça truorë: ndo dī gjë,
 thujme prë lipsī,
 prë nderë të rregjërëshes S[hën] Marī.
 Mos përmëto se të duronj' u më
 e kallëzōmë mbë ç' anë 530
 u mund i gjënjë o ndo te shpia më vanë.

Aristidhi

U si era frīnjë ku dua,
 gjith u xë sa dua të dī,
 u si ajëri jam' i hollë,
 jamë i ghrëllë si një puhjī, 535
 jam' i njomë si një fjollë,
 gjith më ngjatën kush më do.

Fjuturonjë ka një përrua,
 ç' është i thellë sa më të thuaç,
 si një zog mbi lartin mal. 540
 Hinjë e dal kudo të duaç,
 shkapërdhiksinjë më se ngjal
 leqeshit namuri edhe.

Moj nani nëng është ashtu,
 se ngapova, i mjeri u, 545
 ndë një rrjet trëkuzje i fort,

përse kī çë lidhi dje
 zëmrën me zinxirë atje
 më xarris i njerë ndë mort.

Dila

Prë lipsī, ji miri trimë, 550
 kuj fanmīrë të dhëftë qielli
 gjellë, shëndet e sa lutōnë,
 prë lipsī porsīmë ku janë
 bilat [t]ime o kaha vanë!

Aristidhi

Vërteta meritōnë ti, bardhe grua, 555
 të keç sa lusën e vete tue kërkuerë.
 Bilat [t]ënde prë nënë të janë e pak

duhet e prë ndë duorë
ti ji shtrëngonë e i kē.
Njota, ndë se vë rē, se tas të dia 560
vinjin ka rahji posht. I vrejte? I pē?
Ni, je hareme, mblidhi e puthi. U më
e së t' vëlenjë e së të lipsem gjë.

Si fluturë nënë i vajta,
t' i ruojta si di lule, 565
si gruoja ruonë kukule
ndëra te dielli.

I adhorova, i mbajta
me theosore skise
si shënjëta shërbise 570
ardha ka qielli.

Niset po të verë

Kostondini

Mëno, mënou, o vllā,
ndo se vërteta mirë
na do, bëje prë hirë
të thellit mallë tënd. 575

Mos na lërë ndë vā
trīgjerë të një hadhie
e paturë prë mirie
çë tas mbë tij u gjënd.

*Aristidhi, ji mbajturë ka Kostondini, qëndrōnë. Nd' at njëmend rrëvonjin
Jullja e Levkotea.*

Shen' e 5

Jullja, Levkotea, Dila e të thënit

Levkotea

O mëma ime, keq me lig u dhëmbe 580
kurë ndë herë tënde nëng na pē ndë shpī,
si patim prë zakōnë
të bëjim, pa t' e thoj neve njerī.

Moj te kjo dit dju çë anamesa u vū
e na bëri pa trū, 585
sa s' dimi si vate
çë jasht u gjetim si të bjerrafate.

Dila

E dhurova të rënde një dhëmbime
vërteta e një trëmbime
të madhe ashtu, sa një etërë e vetëme sosën 590
e ndë deqe më strosën. Moj si vate,
si qe, si erdhi ashtu kjo pësuome,
së dua më hollë t' e xë. Ni jamë kutjende
me jū ndë këto vende.

Jullja

Po ruoj, po ruoj, o motërë, se prej neve 595
është ëngjëlli që thërrite
kurë jeshënje mbë zalī.
Ai neve duoj të ndihij e ndë llorë

[.....]

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

MELODRAMMA ALBANESE

[L E U C O T E A]

Personaggi

Leucotea e
Giulia – *sorelle di*
Costantino – *tutti e tre figli di*
Domenica – *moglie del defunto Dino.*
Aristide – *giovane che ama Leucotea e ne è riamato.*
Coro di vicini e parenti

La scena

*è nel paese e nei paraggi. Si apre
in una valle tra due colli, sull'uno dei quali si vede il paese;
sull'altro, nella valle e sul pendio si vedono qua e là orti,
vigne, cespugli, rovi, burroni e alberi. Di fronte alla vallata
giù scorre un fiume. Il sole sta per tramontare. Leucotea sola
va come cercando chissà cosa in fondo alla valle.
Resta poi in un posto più isolato. Parla un po' sotto
voce, come tra sé; aumenta pian piano il volume e alla
fine si mette a cantare.*

Atto primo
Scena prima

Leucotea

Cos'ha per me di buono,
di bello cos'ha
questo luogo solingo e senza nessuno attorno?
Colui che vado cercando
non lo trovo dipinto in queste foglie d'ulivo. 5
Non conosco un varco per uscire
dalla condizione di tristezza.
E questo luogo mi piace
senza che sappia come e perché.
Mi pare di aver visto non so cosa, 10
un fantasma, un'ombra.
Non ho avuto paura e sono andata in cerca delle orme.
Le ho trovate ma non riconosciute.
Il caldo all'improvviso ha pervaso il mio corpo
alternandosi al freddo per tre volte 15
senza che me ne rendessi conto.
Una forza nascosta mi ha scosso e trapassato
i nervi, toccandomi le ossa.
Ho chiesto in giro
al vento e ai luoghi che mi indicassero 20
chi è stato a passare di qui.
Gli alberi che mi circondano,
i fiori e le spine che mi stanno al fianco
sono immobili, muti.
Silente attorno a me si stende l'universo, 25
come per osservare quel che dico o intendo fare.
E io da me non ci arrivo
a poter capire
se bene o male
è ciò che bramo e cerco. 30
Come va poi che dolce
la vita mi pare più del miele
in queste valli tacite e profonde?

Chi mi ha preso, strappato,
rubato il cuore? 35
Da quando l'infelice ha capito
cos'è l'amore, più non lo possiedo!

E' stato vero o falso?
Un fatto o un'illusione?
Da me non so dire se sia stato 40
sogno o fantasia.

Scena seconda
Giulia e Leucotea

[Giulia]

Ahi, ah! Sorella mia,
che fai sola
in questa vigna, in questa vallata
malinconica, che in cuore 45
ti incute una paura
terribile tanto da sfigurarti?
Te ne stai sola
senza darti pensiero di chi ha per te
viva preoccupazione? 50
Mamma, tutta agitata,
non vedendoti venire
dopo aver atteso per un pezzo,
era in preda a spavento.
Ti ha prima cercata in casa, 55
poi da amici e parenti,
dai vicini e ovunque
fossi solita andare
in paese, sorella.
Invano, ed in casa 60
non c'era Costa, per mandarlo
alla tua ricerca.
Vedendola uno straccio,
mi sono avviata a cercarti,
pur non sapendo 65
dove chiedere e chiamarti.
Quasi senza volerlo mi sono ritrovata
fuori paese e mi ha portato
da sé il piede per le pendici
fino a questo profondo dirupo. 70

Leucotea

Chi sei tu che vieni qui
a turbarmi i sogni?
L'amore profondo che mi atterra
non basta a consumarmi?
Ecco, la gente invidiosa 75
non vuol lasciarmi sola
un brevissimo istante
a piangere e cantare
il mio destino, come meglio credo.

Giulia

Cielo, che vedo! Che significa
questa totale metamorfosi? 80
Sorella mia, tu mi parli
come una mentecatta.
Ahi, troppo il luogo solitario
la mente bella serena 85
che ti onorava e abbelliva
te l'ha distorta e annebbiata.
Andiamo, sorella! La mamma
vuole che ci ritroviamo a casa
attorno ad essa prima di sera. 90

Leucotea

O Giulia, mi sei tu vicina?
O luce, o bellezza, che sempre mi hai rallegrata
nelle pene, illuminandomi al bisogno.
Se ho avuto una gioia, tu me l'hai raddoppiata,
come fai ora. 95
Accostati, accostati a me, stenditi in queste braccia,
sorella veramente buona,
piena di saggezza e grazia, che meriti
che al petto ti stringa
con tutta la forza dell'affetto che sento per te. 100

Giulia

Via di qui, sorella,
saliamo su un poggio.
Là il sole ci vede e splendendo
bello all'occhio
ci riempie di gioia. 105
Il paese che si scorge dirimpetto
allarga il cuore e il discorrere ci piace
perché siamo al sicuro.
Là ci fermiamo un momento. Se ti va,
mi dirai che cosa hai visto, avuto e patito; 110
se hai visto la fata maligna
o hai rabbrivido per un rumore
o qualche altra spavento
ti ha fatto tremare lo spirito, sorella mia.

Leucotea

Andiamo, ché anch'io 115
ho paura di star qui.

Guarda però, sorella,
se noti qualcosa
nella zona dov'ero.

Mi hai portato la luce, 120
mi hai aperto la mente.
Ora di qui mi togli?
Io ti dico che lì
la mia anima lascio!

Giulia

Ritorna in te, sorella, 125
e muovi con attenzione
il corpo, i piedi e la persona.
Attenta, siamo sul ciglio
di un fosso ricoperto
di ortica e rovi. 130
Cadendoci resteremo
sfregiate, se continui a spingerti avanti
con l'accesa fantasia d'una pazza.

Leucotea

È proprio così, sorella.
Se non torno alla ragione, 135
sono come vite senza palo.
Ecco, un'amara spina mi ha punto il piede,
un'ortica mi ha irritato
la mano destra, e mi ha fatto tremare il petto
un enorme ramarro giallo 140
che fissandomi con l'occhio violaceo
mi ha aggredita.
Madonna mia! Un rospo
mi è saltato sul piede e sono rimasta 145
sfigurata per la paura.
Mi si è bloccata la mente,
Giulia, e respiro a fatica!

Giulia

Andiamo, comunque
è cessato il pericolo!
Il fosso ampio e profondo 150
l'abbiamo agilmente scavalcato
come farfalle.

*Arrivate sul colle, sostano. Leucotea si guarda attorno,
il posto le piace e dice:*

Leucotea

Siamo giunte alla meta prima del previsto,
saltando su per il colle
come corre la cerva, 155
se si trova inseguita,
in cerca d'acqua o d'ombra per sostare.
Mi ansima il cuore, ma mi sento
felice d'esser qui.
Su questo colle ride l'universo. 160
Il cuore mi si allarga e più mi piace la vita
che in quelle valli profonde...

Giulia

... dove continueresti forse a languire,
se non fossi venuta a destarti
dal maligno letargo che assopendoti 165
quasi ti trasbordò nell'altra vita.
Ecco il paese dirimpetto!
Se guardi di qui,
scorgi la nostra vigna.
Se alzi invece gli occhi, 170
vedi il sole al tramonto.

Leucotea

Quanti amori mi desta non so dirlo.
Solo al ricordo mi sento mancare.
Volgiti di qui, Giulia,
ed intona con me 175
una dolce canzone
come a me piace.
Cantiamo ora noi due,
in melodia gioiosa
una strofetta che mi si rassereni la fantasia. 180

Giulia

Bada che il canto sia breve, sorella,
ché per la mamma in attesa
si protrae col ritardo la pena
racchiusa nel cuore per noi.

*Cantano lo stornello tenendosi per mano e volte verso
il fiume sottostante. Aristide sull'altro colle, seduto su una
balza, guarda e sente, non visto da Giulia, scorto però
da Leucotea.*

Stornello

Davanti agli occhi tu mi sei sfrecciato
come il bel raggio, che d'estate splende
d'una stella che fugge e vola via
e indicare dov'era più non sai. 185

Canzoncina

Il luogo veramente si dimentica
nel cielo sterminato,
ma non così il fenomeno
capitato una volta
dovunque sia, dovunque. 190

Pendio, dirupo e valle,
colle, monte e pianoro,
tutto ciò che te l'evoca
l'orecchio ti fa fremere,
l'occhio e con essi l'anima. 195

Controcanto

*con cui Aristide fa loro l'eco loro rispondendo da lontano con voce
sorda e ferma.*

Te lo dicono ed evocano
e narrano le cose
tutte che ti circondano
nello spazio dattorno. 200

Giulia

scossa e meravigliata dice alla sorella:

O Leucotea, mi pare che sul colle
che ci sta dirimpetto,
in quella costa lì,
sotto quel prugno nero
che Bella ha nella vigna
ha risposto una dolce canzonetta.
Ci uccella forse la comare Tore? 205

Leucotea

Davvero? Non l'ho udita! Zitta, zitta!
Ecco, ha ripreso il canto
con voce alta e distesa.
È lei o no? Mi pare
che proprio le somiglia. 210

Non sono certa. Oh, Giulia, 215
ascolta attentamente
e per seguirla bene
sediamoci in quest'ombra.

Canzonetta lontana

Una volta che amore profondo 220
il cuore ti ha vinto,
il luogo fatato ti resta negli occhi
come abbagliante riflesso
o specchio parlante.

Ti dice che fu, che sentisti, 225
che cosa hai nel cuore;
come bella ti parve
l'immagine a te somigliante
comparsa in visione.

Il cuore si agita, vola 230
lo spirito, e il corpo
giace nel posto ove sei,
insensibile.

Sognante l'anima incontra 235
il bene invocato,
lo tocca, lo abbraccia, lo bacia,
lo guarda, e gli parla a suo genio.

Giulia

Che bravo cantore! Chi è là?
La voce armoniosa e serena è ben altra
da quella di Tore.

Mi ha intenerita 240
e, se oltre cantava
un pochino,
di amici e parenti mi avrebbe
infuso l'oblio.

Soavi le note, soavi 245
le chiare parole.
Come anguilla nell'acqua,
nell'anima penetra
quell'armonia.

Leucotea

Reggimi, Giulia... Io cado... non posso tenermi
in piedi; il corpo mi trema... 250
il giorno si vela, si chiudono gli occhi,
per le vertigini a un tratto mi pare
che rotolo giù senza freno.
Non so che mi prende... già cado svenuta!... 255
Dove sono, Giulia? Che faccio?...
Oh, porgi la mano pietosa!
Sorella, stringimi e alzami con le tue braccia.

Giulia

Povera me!
Sorella, che senti? Che hai? 260
Appoggiati a me sul grembo in quest'ombra!
Mi sei appassita qual fiore
alla vampa del fuoco.
Sei pallida come zucchetto esposta ad alito afoso,
qual livida salma sei rigida. 265
E come potrò,
adesso che l'ora mi ha colta,
a casa portarti da qui
senza aiuto?
Sventura accanita! Disgrazia! Che vedo? 270
Un giovane armato a me ignoto
qui viene deciso.
Dove fuggo a nascondermi
senza le altre amiche del cuore
in questo bisogno sì grande? 275
O Mamma celeste, tu porgimi aiuto
o a lui la mente rischiarata che non ci danneggia,
trovandoci sole,
senza senso e consiglio, o fa' pure
che amico o parente ci sia. 280

Scena terza
Aristide e dette

[Aristide]

Non vi conosco e non sono
vicino o parente,
ma dedico a voi
grandissima cura.
Di', con la mano che porgo, ragazza, 285
che cosa fare potrei.

Giulia

Aiutami, senza toccarmi,
a mettere a cavalluccio
mia sorella. Non altro
io voglio da te. 290

Il nostro onore rispetta.
Me la porto da sola,
senza estranei che attorno
la stiano a toccare.

Aristide

Magnanima ragazza, 295
sappi dalla mia bocca, se la ignori,
la cruda verità:
la forza delle mani non s'adegua
sempre al volere, come ora t'illudi.
Da sola non puoi farcela. 300
Ci vuole un altro braccio che la porti.
Serve forza virile
che sulle braccia l'alzi e la riporti.

Spesso il nostro volere
troppe cose vuol stringere; 305
ma se il vigore manca,
rimane inefficace.

Al contrario il volere
porta l'intento a termine,
se lo assiste la forza 310
nei muscoli racchiusa.

Giulia

No, amico! Mia sorella mano alcuna,
che di donna non sia,
non voglio che la tocchi.
Mai lo consentirò, 315
perché nella vergogna,
in critiche malevole in cui guazza la gente
al minimo pretesto,
parte non voglio avere.

Aristide

Un fiore germogliato nella sabbia 320
coglieva un dì un ragazzo

per trapiantarlo nell'orto ove vivere
a suo agio poteva,
al riparo dall'afa.

Il fiore protestò: 325
"Dove son germogliato
lascia che me ne stia,
come finora, intatto,
solo col mio destino!".

Sorpreso e triste il giovane 330
per le parole ingrato,
la sua mano ritrasse.
Di lì passò, cacciato,
un cinghiale ed il fiore
sfigurò calpestandolo. 335

Giulia

Ahi! Viene meno e con essa la luce
per me tramonta. Un uomo,
che sia giovane o anziano,
più vale di una donna.
Mentre era qui, fastidio 340
provavo, non spavento,
né prossima la notte mi pareva.

Ah, per questo gli antichi proclamarono
profonda verità:
bene non si conosce 345
se non perso e goduto.

Ora, rimasta sola,
disperata ed afflitta,
da chi soccorso impetro?
Non d'altri, è mia la colpa: 350
l'aiuto che non volli or non so darmi.
Oh, sorella, tu strilli!

Leucotea - trasognata

Dove fuggendo vai? Ti regge il cuore
di lasciarmi svenuta, derelitta,
e allontanarti in volo? 355

Fa' di me quel che vuoi! Lasciami, ma sepolta!
O portami con te alla tua meta
ove ti serva schiava.

Da me che vuoi, crudele?
Che aspetti? Tra le braccia
ti son caduta come cade l'ora
felice in mano. 360

Giulia – molto confusa

Leucotea, tu deliri? Che giorno sfortunato
per noi quello di oggi!
Forse la stella splendida s'è spenta
che già ci illuminava. 365

Leucotea – delirando

Prendimi con te, angelo,
prendimi, non lasciarmi!
Non curarti se imprecano
mia madre e mio fratello. 370

Con un angelo perdermi
non posso né languire.
Io con te vedo e godo
il Paradiso.

Giulia

Pareva che l'avesse inviato il cielo!
Bello e buono, prudente,
mite, leggiadro, amabile
era il giovane apparso
a prestarmi soccorso nel bisogno.
L'ho rifiutato senza una ragione. 375
Pentita, ora lo invoco
ch'è lontano, sottratto alle mie suppliche. 380

Leucotea – ripresasi

Io ti odo, sorella,
in vece sua.
Come ora sei, con me
resta tranquilla. 385
Mi son ripresa ma non me la sento
di rincasare a piedi.
Fermiamoci un istante,
poi con calma ci avviamo
senza affrettare il passo, ora che poco
distiamo dal paese. 390

Giulia

Ahi! Mi dilani il cuore
coi tuoi detti, sorella, ma non posso
dimenticare mamma. 395

Troppo teme per noi
il fratello che osserva
la mamma in preda al panico!

Non so come dividermi
tra amori che in me lottano: 400
a quale cederò?

Per te mi svuoto e logoro;
per quelli a cui manchiamo
sento trafitta l'anima.

Atto secondo

Scena prima

Domenica e Costantino

*Domenica dalla soglia di casa scorge il figlio che, avendo
invano cercato le sorelle, ritorna triste: lei recita da sola
i primi versi per poi continuare mentre lui si avvicina.*

Il riflesso del cuore addolorato 405
si evidenzia nel volto.

Emesso da lucerna,
lume non sta nascosto
che non sia avviluppato 410
da una nube funesta.

Ecco, ritorna triste
mio figlio e riconosco
dall'andatura che non ha trovato
le sorelle disperse.
Ahi, ah! Povera me! 415
Cosa farò stasera?

Figlio tu torni solo
con in volto dipinto
amaro disinganno.

Sveli col portamento
triste l'esito infausto
di accurate ricerche. 420

Costantino

Davvero, madre mia,
ogni luogo accessibile ho battuto.
Ho gridato e cantato, 425
domandando per via
a giovani, ragazze, vecchie, uomini
e fanciulli incontrati;
coste e valli ho percorso,
esplorato pianure, colli e monti, 430
ma senza rinvenirne alcuna traccia.

Domenica

O figlio mio! Che sera
funesta ci regala il giorno d'oggi!
Forse le ha colte qualche involontaria
imprecazione che a volte ho lanciato. 435
Dove andiamo a cercarle al buio? Dove sono?
Sai, figlio, dov'erano dirette?
Ma perché rimaniamo
imbambolati,
senza darci da fare, 440
in inerte incertezza?
Al lume d'una torcia, quale che sia, la sera
passiamo perlustrando
tra suppliche alla Vergine ed al cielo.

Scena seconda

Il coro e detti

Per questo come valle oscura, senza sole, 445
da stamane sembrava il vicinato
e qual donna discinta in larga gonna.
Desolazione per le vie regnava,
ché mancavano Giulia e Leucotea:
l'una luce per noi, l'altra letizia. 450

Il cielo non ci serbi
prova così penosa.

Dobbiamo rivederle nella cerchia
dove innanzi vivevano. 455
Più fausto dell'esordio mattutino
deve chiudersi il giorno:
stasera tra di noi
vogliamo le ragazze.

Costantino

Mamma, la torcia è accesa. 460
Due ne ho di riserva.
Così asciutte e lievi
alla mano non gravano.
Non è poi così tardi.
E se questa non basta,
accendiamo le altre. 465

Domenica

Andiamo, benedetto figlio! Prima
chiediamo alla Vergine la grazia
di incontrar le sorelle
incolumi, perfettamente sane.

In due

Madre pietosa, per la pena 470
provata quando il figlio
col cuore in gola andavi
ricercando smarrito,
tanto che al ritrovarlo
di giubilo fremesti; 475

Madre pietosa, per la gioia
che tu allora sentisti,
fa' che le figlie incontri
là dove sono andate:
fa' che di primo acchito 480
imbrocchi il posto.

Coro

Sì come avanza celere la nave
da vento favorevole sospinta
sull'onde e in porto approda ove ritrova
ampie intatte ricchezze, 485

così giunga tu, madre, alle tue figlie
e le rinvenga incolumi.

Mentre il coro canta la sua parte, Costantino e Domenica si avviano e, usciti dal paese, al passare per le falde di un poggio, sentono una canzoncina. Quando il coro termina, lui dice alla madre:

Costantino

La senti la canzone, mamma, o no?
Quella che sento è vera
o le orecchie m'ingannano? 490

Domenica

No, figlio, è vera, è vera! Di cogliere badiamo
dove viene, che dice.
Forse Dio per amore
della Vergine ci apre qualche via
e una luce ci mostra 495
che ci guidi sicure
al luogo dove forse
attendono l'aiuto che non hanno.

Scena terza

*Domenica e Costantino avanzano verso un colle,
sulla cima del quale canta*

Aristide

Luna dai bianchi corni, con il volto
spunta splendido, argenteo. Della notte 500
o gioiosa compagna, ora disvela
i raggi sospirati.
In valli e forre profonde s'addensino
adunate le tenebre. Degli uomini
ove ferve la vita, invece irradia 505
beata dal candido tuo corpo!

Domenica

Mai così dolce in cuore
mi si spinse una voce
come questa che ascolto!
Con sortilegio magico 510
mi ha rapito lo spirito.

Aristide

*sceso dalla cima del colle, da dietro un rialzo vicino alla via
canta.*

Ti cerca, ti supplica forse
la fanciulla smarrita
che ignora la via del ritorno.

Forse ti invoca, ti aspetta impaziente 515
la mamma dal cuore trafitto,
ché accanto non ha la famiglia.

Scena quarta

*Domenica, Costantino e il detto, che termina il canto arrivando
sulla strada.*

Domenica

Come indovini, giovane felice,
ciò per cui prego e supplico. 520
Vado cercando

due figliole smarrite e non so dove,
confusa, desolata,
di qua e di là come uccello senz'ali.

Te, angelo che in canto 525
mi hai rivelato l'intimo,
te supplico: se sai qualcosa, dimmelo
per carità, in nome
della beata Vergine.

Non lasciar che più soffra 530
e narrami in che parte
posso trovarle o se son rincasate.

Aristide

Io donde voglio soffio come il vento,
tutto so ciò che voglio. 535
Sottile come l'aria,
flebile come brezza,
morbido come canapa,
chi mi afferra mi snoda.

A guisa d'uccello da un dirupo
profondissimo volo 540
su di un monte elevato.
Entro ed esco a piacere,

pur dai lacci d'amore
guizzo più d'un'anguilla.

Ora non è così: sono incappato,
misero, in una rete
dalle maglie ritorte.

545

Chi solo ieri il cuore
me lo ha incatenato
mi trascina alla morte.

Domenica

Per carità, ragazzo,
a cui beato il cielo
vita, salute ed ogni bene dia,
dimmi dove si trovano
le figlie o sono andate.

550

Aristide

Candida donna, veramente meriti
di avere quanto brami e vai cercando.
Hai le tue figlie a un passo
e a breve tra le mani
potrai tenerle e stringerle.
Ecco, se ci fai caso, l'una e l'altra
discendono dal colle. Le hai notate?
Lieta accoglile e baciale. Di me
più tu non hai bisogno.

555

560

Pari a farfalla ho svolazzato attorno,
come fiori serbandole,
al modo che la donna serba i bozzoli
esposti al sole.

565

Le ho vegliate adorandole
con divino rispetto
come creature sacre
dispensate dal cielo.

570

Fa per andare

Costantino

Resta, resta, fratello,
se bene veramente

ci vuoi. Via, fallo in nome
del tuo amore profondo.

575

Non lasciarci nel mezzo
d'una gioia grandissima,
dono della bontà
che in te si è ritrovata.

*Aristide, trattenuto da Costantino, resta. In quel momento arrivano
Giulia e Leucotea.*

Scena quinta
Giulia, Leucotea, Domenica e detti

Leucotea

Troppo ti sei doluta,
mamma, non rivedendoci
a casa all'ora solita,
come ogni giorno, per costume innato.
Oggi non so che cosa
s'è messo di traverso e scervellate
tanto ci ha rese da finire improvvide
in ignota campagna.

580

585

Domenica

Un pesante dolore e una paura
davvero ho sopportato
così grande che un'altra basterebbe
per cedermi alla morte. Com'è andata,
come tutto è avvenuto,
non voglio più indagarlo. Sono lieta
d'essere qui con voi.

590

Giulia

Guarda, sorella! L'angelo
che invocavi quand'eri in mancamento
è qui vicino a noi.
Lui voleva soccorrerci ed in braccio

595

[.....]

N O T E

267 zuri] zëri.

476 *hajdhinë*, per analogia con il *helëmin* del verso 470 va letto metricamente *hàjdhin*.

485 ku] kë.

487 (+) Per motivi di chiarezza ho spostato dopo questo verso la didascalia che nel ms si trova dopo il v. 481.

Il melodramma riprende e amplia all'inverosimile il tema, già presente nella Neomenia, della ragazza smarrita nel bosco. La trama, così inconsistente da non consentire uno sviluppo credibile, offre all'autore il pretesto per proporre una serie di arie, ricche di musicalità anche grazie al sapiente uso della rima.

6 luglio 2013